




Pranuar / Dorezuar Prenheno / Predato Received / Delivery	05-05-2021	viti god year	1
Organ / Rjeshtja Organ / Jedinitca Org / Unit	Br Prot Br Prot Prot No	Shtopje Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SAPMS/EX	2172/2021		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.157/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.157/2021 të datës 19.03.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi Rr.“Izet Hima” Nr.318 Gjakovë, kundër organit të punësimit Komuna e Gjakovës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 05.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.157/2021 e datës 19.03.2021 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Komunën e Gjakovës, më datë 19.03.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1275/2020 të regjistruar me A.nr.157/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e diferencës së pa paguar në vlerë prej 50% të pagës gjatë kohës sa ka qenë e pezulluar nga puna respektivisht nga data 21.04.2016 deri me datë 08.01.2021, duke i llogaritur edhe dëmin e shkaktuar nga diferenca e pagave të papaguar së bashku me kamatat ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 25.03.2021 përmes shkresës me numër protokolli 1398/2021 ka proceduar kërkesën për përgjigjen në ankesë të Komuna e Gjakovës. Ndërsa më datë 14.04.2021 Komuna e Gjakovës ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për vërtetimin e drejtë dhe plotë të gjendjes faktike si dhe vendosje të drejtë të çështjes, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 1275/2020 të datës 19.03.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin me numër PKR. Nr. 309/2014 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda të datës 21.03.2019; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 25.03.2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 14.04.2021 me numër protokoll:1773/2021; Akt emërimit e ankueses të datës 12.03.2012; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Sektorit për Çështje pronësore Juridike; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Gjakovës me numër 01 Nr.116-21952/2016 i datës 21.04.2016; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Gjakovës me numër Nr.01-112/02-30379 të datës 17.12.2020; Kërkesën për opinion ligjor dërguar nëpërmjet e-maili të datës 24.03.2021 nga _____ për Fletëkthesa e datës 06.01.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa A.nr.157/2021 e datës 19.03.2021 e parashtruar nga ankuesja _____ është e palejuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht Akt Emërimit të datës 12.03.2012 me numër 112-143/5, Kolegji ka konstatuar se ankuesja ka qenë e punësuar në Komunën e Gjakovës në pozitën "Udhëheqëse e Kadastrit për Çështje Juridike", e njëjta me Vendimin me 01Nr.116-21952/2016 të datës 21.04.2016 të Kryetarit të Komunës së Gjakovës, ishte pezulluar me 50% të pagës deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Gjykata, për shkak të fillimit të procedurës penale ndaj saj me dyshimin e kryerjes së veprës penale gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare Me Aktgjykimin PKR Nr.309/14 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, i plotfuqishëm me datë 11.02.2020, ankuesja është liruar nga akuza, dhe e njëjta më datë 27.11.2020 ka parashtruar kërkesë të organi të punësimit për rikthim në vendin e punës.

Me Vendimin me numër protokoll 01-112/02-30379 të datës 17.12.2020, të Kryetarit të Komunës së Gjakovës, ankuesja _____ nga data 08.01.2021, është kthyer në pozitën e punës Udhëheqëse e Sektorit për Çështje Pronësore Juridike, pranë Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

Në ankesën e parashtruar në Këshill, ankuesja pretendon që ti njihet e drejta për kompensimin e diferencës së pa paguar në vlerë prej 50% të pagës gjatë kohës sa ka qenë e pezulluar prej datës 21.04.2016 deri me datë 08.01.2021 duke i llogaritur edhe dëmin e shkaktuar nga diferenca e pagave të papaguar së bashku me kamatat ligjore pasi që e njëjta me Aktgjykimin PKR. Nr. 309/2014 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda të datës 21.03.2019 është liruar nga akuza.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në provat e lëndës ka konstatuar se ankuesja për njohjen e kësaj të drejte nuk i është drejtuar paraprakisht me kërkesë organit të punësimit, respektivisht udhëheqësit me të lartë administrativ si organ kompetent për trajtimin e kësaj çështje, kështu që lidhur me këtë objekt të ankesës nuk kemi veprim apo mosveprim të organit të punësimit në raport me të drejtën e pretenduar në ankesë, për çka ankuesja mund të kontestonte ligjshmërinë e veprimit të organit të punësimit, apo mosveprimin e tij, ashtu siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat e Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 3 ku përcaktohet se: 3.Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë



drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht neni 124 ku përcaktohet se: 1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim”.

Çështja e parashtrimit të ankesës kundër vendimit të organit të punësimit është e përcaktuar edhe me nenin 16 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, meqenëse ankuesja në këtë procedurë nuk ka parashtruar fillimisht kërkesë pranë organit të punësimit, Kolegji vlerëson se nuk janë përmbushur kushtet për pranueshmerinë e ankesës, siç përcaktohet me nenin 129 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.157/2021

Elakron GASHI


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

